



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për Landfillet e mbetjeve”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Projektvendimi “Për landfillet e mbetjeve”, i hartuar në mbështetje të nenit 34, pikave 1, 7 dhe 9, të nenit 35, pika 4, nenit 36, pika 4 dhe nenit 80 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), për periudhën 21.5.2026 – 18.6.2026.

3. Metoda e konsultimit

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektvendimi është publikuar në portalin RENJKP, duke u dhënë mundësi të gjitha palëve të interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime për përmirësimin e tij.

4. Palët e interesit të përfshira

Eksperte mjedisi.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Projektvendimi, gjatw periudhws sw konsultimit publik ka patur 260 shikime dhe 2 (dy) komente nga faqja e RENJKP.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Projektvendimi “Për Landfillet e mbetjeve”	Projektvendimi nuk përcakton saktësinë sesa është transpozuar (pjesërisht... Plotësisht??) Direktiva e Këshillit 1999/31/EC të 26 prillit 1999 Për landfillet e mbetjeve dhe	Z.Polikron Horeshka	I pranuar pjesërisht	Në projektvendim është reflektuar shkalla e përputhshmërisë së projektaktit kombëtar me acquis-in e Bashkimit Evropian që synohet të përafrohet.

	<p>Vendimin e Këshillit 2003/33/EC të 19 dhjetorit 2002, i cili vendos kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve në landfill, në zbatim të nenit 16 të shtojcës II të direktivës 1999/31/EC. OJ L 11/27, datë 16.1.2003., por paraqet vetëm në formë arrative (kërkohe të përcillet informacion sesa është traspozuar projektvendimi me Direktivën sipas neneve të RIA).</p>			<p>Në kuadër të hartimit të projektvendimit është përgatitur tashmë tabela e përputhshmërisë, e cila pasqyron në mënyrë të detajuar nivelin e përafrimit të dispozitave të projektvendimit me Direktivën 1999/31/KE dhe Vendimin 2003/33/KE.</p> <p>Kjo tabelë është pjesë e dokumentacionit mbështetës të procesit të përafrimit dhe nuk përbën pjesë përbërëse të tekstit normativ të projektvendimit.</p> <p>Sa i përket referimit në RIA, sqarohet se: projektvendimi në fjalë nuk shoqërohet me një dokument të veçantë të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA);</p>
	<p>Në nenin 1 të projektvendimi përcaktohen kriteret, procedurat dhe standardet për studimin, projektimin, ndërtimin, funksionimin dhe mbylljen e landfilleve, por nuk jepet përcaktimi se cili institucion do të kryejë këtë procedurë teknike. Kërkohe informacion cfarë kriteresh teknike do të përdoren për përcaktimin e kriterëve dhe kostot financiare që do të trajtohen për ndërtimin dhe mbylljen e landfilleve.</p>	<p>Z.Polikron Horeshka</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi nuk synon të përcaktojë një institucion të vetëm përgjegjës për të gjitha fazat e studimit, projektimit, ndërtimit dhe operimit të landfilleve, pasi këto procese janë të shpërndara ndërmjet disa autoriteteve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në mënyrë të qartë në projektvendim janë përcaktuar: roli i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) në procesin e miratimit përmes lejes së mjedisit dhe kontrollit të përmbushjes së kushteve; përgjegjësitë e operatorit për studimin, projektimin, ndërtimin,</p>

				<p>operimin dhe mbylljen e landfillit; detyrimet për raportim, monitorim dhe kontroll gjatë gjithë ciklit të jetës së landfillit.</p> <p>Sa i përket kriterëve teknike, këto janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Shtojcën I të projektvendimit, e cila përfshin kërkesat për përzgjedhjen e vendndodhjes, mbrojtjen e ujërave dhe tokës, sistemet e izolimit, menaxhimin e lëngjeve kulluese dhe kontrollin e gazit të landfillit; gjithashtu, Shtojca II përcakton kriteret dhe procedurat për pranimin e mbetjeve, në përputhje me standardet përkatëse.</p> <p>Sa i përket kostove financiare, projektvendimi përcakton parimet dhe mekanizmat financiarë, përfshirë tarifimin dhe garancitë financiare për operimin, mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes ; vlerat konkrete të kostove nuk mund të përcaktohen në këtë akt, pasi ato varen nga parametrat specifikë të çdo landfilli (kapaciteti, teknologjia, vendndodhja dhe zgjidhjet inxhinierike), të cilat përcaktohen në fazën e projektimit dhe në dokumentacionin për leje mjedisi.</p>
	Në projektvendimin e Landfillet klasifikohen në tri kategori: a. landfille për mbetjet e rrezikshme;	Z.Polikron Horeshka	I refuzuar	Projektvendimi përmban në mënyrë të plotë kërkesat teknike dhe kriteret bazë që lidhen

	<p>b. landfille për mbetjet jo të rrezikshme; c. landfille për mbetjet inerte. Në draftdokumentin nuk jepen detaje lidhur me: - Për klasifikimin e llojeve të tokave që do të përzgjidhet landfilli; - Llojet e shresave të membramave të ndërtimit të landfillit; - Distancat e shtretëzimit; - Llojet e tubacionit të përthithjes së biogazit; - Llojet e impianteve të trajtimit të llumrave të gjeneruara nga landfilli; - Për përzgjedhjen e vendndodhjes së një landfilli merren në konsideratë kërkesat që lidhen me: - distancën nga kufiri i vendit të landfillit deri te zonat e banuara dhe zonat e pushimit/rekreative, rrjedhat e ujit, trupat ujorë dhe zonat e tjera bujqësore ose urbane; - ekzistencën e ujërave nëntokësore, ujërave bregdetare ose zonave natyrore të mbrojtura në këtë zonë; - kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike në këtë zonë; - rrezikun e përmbytjes, fundosjes, shkarjes së dherave, ose të rënies së orteqeve në këtë - vend; - mbrojtjen e trashëgimisë natyrore e kulturore në këtë zonë; - kontrollohen ujërat që futen në trupin e landfillit nga precipitimet/reshjet; - Barriera gjeologjike që do të përcaktohet nga kushtet gjeologjike dhe</p>			<p>me projektimin, ndërtimin dhe operimin e landfilleve, në përputhje me natyrën e një akti rregullator të këtij niveli. Në mënyrë specifike: Shtojca I e projektvendimit përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat teknike për: përzgjedhjen e vendndodhjes (kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike, ujërat nëntokësore, zonat e mbrojtura, rreziku i përmbytjeve apo shkarjeve); mbrojtjen e tokës dhe ujërave; barrierën gjeologjike dhe sistemet e izolimit; kontrollin e ujërave dhe menaxhimin e lëngjeve kulluese; kontrollin e gazit të landfillit dhe stabilitetin e strukturës; ndërsa Shtojca II përcakton kriteret dhe procedurat e pranimit të mbetjeve, në përputhje me standardet përkatëse. Sa i përket elementeve të kërkuara në koment, si: llojet specifike të membranave, dimensionimi i shtresave, teknologjitë e tubacioneve; zgjidhjet inxhinierike për kapjen e gazit apo trajtimin e lëngjeve; parametrat e detajuar gjeoteknikë apo hidraulikë;</p>
--	--	--	--	--

	<p>hidrogeologjike në afërsi të vendit të lëndfillit etj... Për pikat e pyetjeve të mësipërme kërkohet të përcillet informacion mbi metodologjinë që do të zhvillohet ndërtimi i landfillëve.</p>			<p>këto nuk janë objekt i rregullimit në një vendim të Këshillit të Ministrave, pasi përbëjnë detaje teknike të projektimit inxhinierik, të cilat përcaktohen në fazën e studimit dhe projektit teknik nga subjekte të licencuara; vlerësohen dhe miratohen në kuadër të procedurës së lejes së mjedisit, në përputhje me nenet 8–10 të projektvendimit; varen nga karakteristikat konkrete të çdo vendndodhjeje (tokë, klimë, teknologji, kapacitet). Për më tepër, projektvendimi përcakton metodologjinë në nivel parimor, përmes kërkesës që projektimi dhe ndërtimi të bazohen në: analizën e kushteve gjeologjike dhe hidrogeologjike; parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave; sistemet e kontrollit të lëngjeve dhe gazit; garantimin e stabilitetit dhe sigurisë së landfillit.</p>
	<p>Në relacionin teknik nuk ka të përcaktuar saktësisht një shtjellim shterues për përcaktimin e kostos financiare për ndërtimin e venddepozitimeve të reja dhe mbylljen e landfillëve ekzistues për procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit, metodologjinë për llogaritjen e garancive financiare,</p>	<p>Z.Polikron Horeshka</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi përmban një rregullim të plotë në nivel parimor dhe normativ lidhur me aspektet financiare, teknike dhe operacionale të landfillëve, ndërsa detajimi i kostove konkrete dhe metodologjive të llogaritjes nuk përbën objekt të një akti të këtij niveli. Në mënyrë konkrete:</p>

	<p>dokumentacionin dhe procedurat për administrimin e tyre, si dhe kërkesat specifike për regjimin operacional të landfillleve ekzistuese. Kërkohet të përcillet një informacion për përlllogaritjen e kostos financiare për pikën 4 të mësipërme.</p>		<p>Për kostot dhe mekanizmat financiarë, projektvendimi përcakton qartë se tarifa për depozitimin e mbetjeve mbulon kostot e ndërtimit, operimit, si dhe kostot e mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes; garancitë financiare për operimin dhe për mbylljen/kontrollin pas mbylljes janë të detyrueshme. Për metodologjinë e garancisë financiare, projektvendimi përcakton elementët mbi të cilët bazohet llogaritja (kapaciteti, teknologjia, sipërfaqja, kostot e monitorimit, etj.); parashikon që metodologjia e detajuar për llogaritjen e garancisë financiare të përcaktohet në Shtojcën VII, si dhe dokumentacioni dhe procedurat në Shtojcën VIII; Për kontrollin, vetëmonitorimin dhe regjimin operacional, kërkesat janë të detajuara në: nenin 12 dhe Shtojcën III (procedurat e kontrollit dhe vetëmonitorimit); nenet 14–15 dhe Shtojcën IX (regjimi operacional dhe plani i përmirësimit për landfillet ekzistuese). Sa i përket përlllogaritjes së kostove konkrete financiare këto varen nga parametrat specifikë të çdo landfilli (vendndodhja, kapaciteti,</p>
--	--	--	---

				teknologjia e përdorur, zgjidhjet inxhinierike, kushtet gjeologjike etj.); për rrjedhojë, ato përcaktohen në fazën e studimit dhe projektit teknik, si dhe në dokumentacionin që shoqëron aplikimin për leje mjedisi;
	Referuar pikën 3 të nenit 21 citon: Kur mbetjet bashkiake eksportohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime depozitimi në landfill, këto mbetje përlllogariten në sasinë e mbetjeve të depozituara në landfill në Shqipëri. - Bazuar në ligjin nr. 57 datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” përcakton që është e ndaluar depozitimi i mbetjeve në landfill të vende të BE dhe vende të ndryshme të shteteve të tjera, pse në këtë pikë keni lejuar eksportin e mbetjeve në landfill jashtë objektit të ligjit të mbetjeve??? Kërkohet një sqarim dhe informacion të thelluar për këtë pikë.	Z.Polikron Horeshka	I refuzuar	Komenti nuk merret në konsideratë, pasi bazohet në një interpretim të pasaktë të dispozitës. Dispozita në fjalë ka karakter ekskluzivisht metodologjik për qëllime raportimi dhe përlllogaritjeje, dhe nuk përbën në asnjë rast autorizim për eksport të mbetjeve në kundërshtim me ligjin nr. 57/2025.
	Në projektvendim nuk përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij akti. Cilët nga institucionet do të jenë për zbatim dhe çfarë roli do kenë ato në zbatimin e këtij akt	Z.Polikron Horeshka	I refuzuar	Projektvendimi përcakton qartë institucionet përgjegjëse për zbatim nëpërmjet dispozitave përkatëse, konkretisht rolin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në procesin e lejeve, monitorimit dhe kontrollit, si dhe përgjegjësitë e operatorit dhe institucioneve të tjera

				sipas kompetencave të tyre të përcaktuara në legjislacionin në fuqi,
	<p>Shuma e garancisë, llogaritet në masën 2% të vlerës së ndërtimit të landfillit por në asnjë rast më e vogël se 10 milion lekë. Me çfarë baze ligjore është përcaktuar kjo vlerë 2% e garancisë dhe sa është kostoja e ndërtimit, rehabilitimit dhe mbylljes së landfillit, të cilët nuk është përcaktuar në projektvendim. Kërkoheq sqarim për këtë pikë të përlogaritjes së garancisë financiare</p>	Z.Polikron Horeshka	I refuzuar	<p>Përcaktimi i detyrimit për garanci financiare mbështetet në ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili parashikon përgjegjësinë e operatorit për mbulimin e kostove të operimit, mbylljes dhe kujdesit pas mbylljes së landfillit, si dhe në parimin “ndotësi paguan”.</p> <p>Në këtë kuadër, përcaktimi konkret i nivelit të garancisë (2% dhe pragu minimal) është bërë në këtë projektvendim si akt nënligjor, në ushtrim të kompetencës rregullatore për të garantuar mbulim efektiv të rreziqeve financiare që lidhen me aktivitetin e landfillimit, dhe nuk rrjedh nga një përqindje e paracaktuar në ligj.</p> <p>Sa i përket kërkesës për përcaktimin e kostove të ndërtimit, rehabilitimit dhe mbylljes së landfillit, këto kosto varen nga parametrat konkretë të çdo landfilli (vendndodhja, kapaciteti, teknologjia, kushtet gjeologjike dhe zgjidhjet teknike); për rrjedhojë, ato nuk mund të standardizohen në një akt me natyrë të përgjithshme si projektvendimi. Kostot konkrete përcaktohen në</p>

				fazën e projektit teknik dhe vlerësohen në kuadër të procedurës së lejes së mjedisit, në përputhje me kërkesat e këtij akti dhe legjislacionit në fuqi.
	Në pikën 5 të nenit 14 të projektvendimit citon: - Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit dhe vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për zbatimin e tyre, periudhë e cila në çdo rast përfundon në datën 31.12.2038, e dërgon atë së bashku me relacionin shpjegues teknik për informacion pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Afati i lënë deri në 2038 për planin e përmirësimit mos është një afat shumë i gjatë gati 12 vite mos është një periudhë shumë e gjatë dhe cila është baza ligjore që është përcaktuar ky afat pasi në Direktivën bazë të venddepozitimeve nuk është e përcaktuar. Kërkoheq sqarim për këtë pikë.	Z. Polikron Horeshka	I refuzuar	Përcaktimi i afatit deri në datën 31.12.2038 lidhet me periudhën tranzitore për përshtatjen e landfilleve ekzistuese, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 57/2025, si dhe me qasjen e përcaktuar në Direktivën 1999/31/KE dhe dokumentet përkatëse të planifikimit të zbatimit të saj (DSIP), të cilat parashikojnë përshtatje graduale pa vendosur afate të unifikuara detyruese. Për rrjedhojë, afati i vendosur përbën një përcaktim të arsyetuar në kuadër të planifikimit kombëtar dhe zbatimit progresiv të standardeve për landfillet ekzistuese.
	Në vlerësimin tonë, ekziston një mospërputhje ndërmjet objektivave të projektvendimit dhe përmbajtjes së tij konkrete, në lidhje me zbatimin e hierarkisë së mbetjeve dhe konceptin e landfillit si alternativë e fundit e menaxhimit të mbetjeve. Projektvendimi synon reduktimin progresiv të	Z. Alban Zusi	I refuzuar	Projektvendimi është hartuar në zbatim të ligjit nr. 57/2025, i cili përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe detyruese hierarkinë e mbetjeve dhe përdorimin e landfillit si alternativë të fundit. Zbatimi i këtij parimi sigurohet nëpërmjet: -sistemit të lejeve të mjedisit;

	<p>depozitimit në landfill dhe nxitjen e riciklimit dhe rikuperimit, por nuk parashikon mekanizma konkrete që të garantojnë zbatimin praktik të këtyre objektivave.</p> <p>Referuar nenit 6 të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, hierarkia e mbetjeve zbatohet në mënyrë të detyrueshme në këtë rend:</p> <ul style="list-style-type: none"> • parandalimi; • përgatitja për ripërdorim; • riciklimi; • rikuperimi; • asgjësimi. <p>Nga kjo rezulton se asgjësimi është një alternativë e fundit dhe nuk duhet të përdoret si mënyrë e zakonshme trajtimi për mbetjet e patrajtuara. Ky parim përforcohet edhe nga ligji nr. 9010/2003, i cili parashikon se groposja është etapa përfundimtare e administrimit të mbetjeve.</p> <p>Megjithatë, projektvendimi nuk përcakton detyrime konkrete për të garantuar që përpara depozitimit në landfill janë konsumuar alternativat e tjera të trajtimit.</p> <p>Për këtë arsye, sugjerohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përfshirja e konceptit të “hedhurinës”; • përcaktimi që në landfill depozitohen 			<p>-kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente;</p> <p>-kritereve dhe -procedurave të pranimit të mbetjeve në landfill të parashikuara në projektvendim dhe shtojcat përkatëse. Projektvendimi ka karakter rregullator dhe nuk synon të përsërisë apo të detajojë dispozitat e ligjit bazë ose të vendosë procedura të veçanta administrative për çdo fluks mbetjesh. Përfshirja e mekanizmave të tillë në këtë akt nuk është e nevojshme dhe do të dilte jashtë objektit dhe natyrës së tij rregullatore.</p>
--	--	--	--	---

	<p>vetëm mbetje të trajtuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vendosja e detyrimit që prodhuesi të dokumentojë pamundësinë e trajtimit; • detyrimi për operatorin që të verifikojë këtë dokumentacion. 			
	<p>Në vlerësimin tonë, projektvendimi nuk adreson në mënyrë të mjaftueshme trajtimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human, të cilat përbëjnë një kategori të veçantë mbetjesh me ndikim të lartë mjedisor dhe sanitar.</p> <p>Në projekt nuk ka një dispozitë të qartë që të ndalojë depozitimin në landfill të tyre, ndërkohë që ato paraqesin rrezik të shtuar për mjedisin, për shkak të përmbajtjes së lartë lagështie, potencialit për gjenerim të leachate, si dhe rrezikut për përhapjen e mikroorganizmave patogjenë.</p> <p>Për këtë arsye sugjerohet që të parashikohet shprehimisht ndalimi i depozitimit në landfill, ose që pranimi i tyre të kushtëzohet me respektimin e legjislacionit veterinar dhe dokumentimin e</p>	Z. Alban Zusi	I refuzuar	Regjimi juridik i nënprodukteve shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore rregullohet nga legjislacioni i posaçëm veterinar, i cili përcakton mënyrat e trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit të tyre. Projektvendimi nuk ndërhyr në këtë regjim, por zbatimi i tij bëhet në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Për rrjedhojë, përfshirja e dispozitave të posaçme në këtë akt do të sillte mbivendosje normative të panevojshme.

	pamundësisë së trajtimit në impiante alternative			
	Sugjerohet që mbetjet biodegradueshme, mbetjet ushqimore dhe mbetjet e tjera me potencial rikuperimi të mos pranohen në landfill kur në territorin e Republikës së Shqipërisë ekzistojnë kapacitete të autorizuar për trajtimin ose rikuperimin e tyre. Në të njëjtën kohë, propozohet vendosja e mekanizmave ekonomike (si tarifa shtesë për landfillimin), me qëllim orientimin e mbetjeve drejt proceseve të trajtimit dhe rikuperimit.	Z. Alban Zusi	I refuzuar	Parimi që mbetjet me potencial rikuperimi duhet të shmangen nga landfillimi është parashikuar në ligjin nr. 57/2025 dhe në politikat për ekonominë qarkulluese. Projektvendimi rregullon kërkesat teknike dhe procedurale për landfill-et dhe nuk ndërhyr në politikat e drejtimit të flukseve të mbetjeve apo në vendosjen e instrumenteve ekonomike, të cilat rregullohen në kuadër të politikave sektoriale dhe fiskale.
	Në nenin 2 të aktit përcaktohet se “mbetje e biodegradueshme” është çdo mbetje që mund t’i nënshtrohet dekompozimit biologjik, si mbetjet ushqimore, bimore, letra dhe kartoni. Megjithatë, në praktikë ky koncept po interpretohet në mënyrë të gabuar, duke përfshirë edhe produktet ushqimore me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human, mbetjet teknologjike shtazore dhe nënproduktet shtazore, të cilat nuk përbëjnë mbetje urbane biodegradueshme, por kategori të veçanta materiale që i nënshtrohen legjislacionit të posaçëm veterinar.	Z.Alban Zusi	I refuzuar	Projektvendimi përdor përkufizimet dhe klasifikimet e përcaktuara në ligjin nr. 57/2025 dhe në kuadrin përkatës ligjor për mbetjet. Ai nuk synon të ndryshojë apo të riformulojë sistemin e klasifikimit të mbetjeve, ndërsa kategoritë e veçanta si nënproduktet shtazore trajtohen sipas legjislacionit përkatës sektorial.

	<p>Fakti që këto materiale janë biologjikisht të degradueshme nuk përbën kriter juridik për klasifikimin e tyre si “mbetje biodegradueshme”, pasi klasifikimi bazohet në origjinën, natyrën dhe rreziqet e mbetjes dhe jo vetëm në karakteristikat fizike të saj.</p> <p>Për rrjedhojë, sugjerohet që projektvendimi të saktësojë shprehimisht se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • koncepti i “mbetjeve biodegradueshme” nuk përfshin produktet ushqimore me origjinë shtazore të papërshtatshme për konsum human, mbetjet teknologjike shtazore dhe nënproduktet shtazore; • këto kategori duhet të trajtohen sipas legjislacionit të posaçëm dhe të mos orientohen drejt depozitimit në landfill si mbetje biodegradueshme. 			
	<p>Sipas përvojës së subjektit, në praktikën administrative nënproduktet shtazore dhe produktet ushqimore me origjinë shtazore janë trajtuar si mbetje biodegradueshme dhe janë depozituar në landfill, gjë që</p>	<p>Z. Alban Zusi</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Projektvendimi synon të vendosë kuadrin rregullator për zbatimin në vijim dhe nuk adreson drejtpërdrejt praktikën administrative të mëparshme. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i legjislacionit sigurohet nga autoritetet</p>

	konsiderohet si një praktikë e pasaktë dhe e rrezikshme.			kompetente nëpërmjet procedurave të kontrollit dhe inspektimit.
	Sugjerohet vendosja e detyrimit për ndarjen në burim dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve ushqimore nga operatorët ekonomikë (restorante, hotele, etj.), me qëllim orientimin e tyre drejt kompostimit, biogazit apo rikuperimit.	Z. Alban Zusi	I refuzuar	Detyrimet për ndarjen në burim dhe menaxhimin e diferencuar të mbetjeve janë të parashikuara në ligjin nr. 57/2025 dhe aktet përkatëse zbatuese. Projektvendimi ka objekt të kufizuar rregullimin e landfill-eve dhe nuk përfshin rregullimin e plotë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në burim.